Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Kreshnik Spahiu	**11.12.2023**	**18.12.2023**	**2023/0984**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 05.12.2023, Operatori Ekonomik (OE) "DWH-Albania SH.P.K."- Tiranë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0984, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "*Furnizimi me pajisje GPS-GNSS dhe tablet për matje gjeodezike" me nr. të prokurimit: "70433736-23-5051-1-2-1*", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL PRISHTINA SH.A. AK ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 25,000.00 €.

Lidhur me këtë lëndë janë nxjerr vendime të mëparshëm të OSHP - së, më numër: 2023/0362 i datës: 16.08.2023 dhe 2023/0638 i datës 18.10.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura

LPP 04/L-42, i permiresuar dhe plotesuar nga ligjet 04/L-237, 05/L-68 dhe 05/L-92 Neni 1, 7, 28, 59

Rregullorja e Prokurimeve Publike 001/2022, Neni 39.5 dhe 39.9, si dhe Neni 40.8

Vendimi i OSHP 2023/0188 (metdologjia e verifikimit te formateve)

Pretendime ankimore

VENDIMI I AK

Është kërkuar:

6. Të jete e pajisur me programin për mbledhjen e te dhënave në terren me licence që importon/eksporton këto formate të dhënash: DWG, CSV, txt, Shapefile

Progami i ofruar ne dosje te tenderit LandStar 8, nuk ofron mundesi te importimit/eksportimit te të dhenave në formatet DWG dhe Shapefile sic jane kerkuar ne Aneksin 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME

VENDIMI I AK Per Kerkesen per Rishikim

Cilesohet si e Pabazuar kerkesa per Rishikim e OE DWH - ALBANIA SHPK

Faktet dhe Detajet

Perpara se te bejme aresyetimin / argumentimin tone po parashtrojme faktet vizive (pa koment):

Fakti 1: Format DWG (pa koment)



Burimi: D2_CHC_Raporti Teknik, Pict. 3.1 (Screenshoot nga LS8)

AK ne vendimin e vet konstaton, qe LandStar 8, nuk ofron mundesi te importimit/eksportimit te

të dhenave në formatet DWG.

Pyetje per OSHP: Ky fakt ku te con ne pohimin apo mohimin e formatit DWG?

Fakti 2: Format Shp (pa koment)



Burimi: D2_CHC_Raporti Teknik, Pict. 3.2 (Screenshoot nga LS8)

AK ne vendimin e vet konstaton, qe LandStar 8, nuk ofron mundesi te importimit/eksportimit te të dhenave në formatet Shapefile

Pyetje per OSHP: Ky fakt ku te con ne pohimin apo mohimin e formatit Shapefile?

Fakti 3: Formati Shp (pa koment)



Burimi: D2_CHC_Raporti Teknik, Pict. 5 (Screenshoot nga LS8)

AK ne vendimin e vet konstaton, qe LandStar 8, nuk ofron mundesi te importimit/eksportimit te të dhenave në formatet Shapefile

Pyetje per OSHP: Ky fakt ku te con ne pohimin apo mohimin e formatit Shapefile?

FAKTI 4: Formati TXT (pa koment)



Burimi: D2_CHC_Raporti Teknik, Pict. 1 (Screenshoot nga LS8)

KUJDES:

Formati TXT eshte akceptuar nga AK!

Kujdes: Ku ndryshon Formati DWG dhe Shp nga Formati TXT?

FAKTI 5: Formati CSV (pa koment)



Burimi: D2_CHC_Raporti Teknik, Pict. 2 (Screenshoot nga LS8)

KUJDES:

Formati CSV eshte akceptuar nga AK!

Kujdes: Ku ndryshon Formati DWG dhe Shp nga Formati CSV?

Fakti 6: Formati Shp (pa koment)



Burimi: D3_Datsheet LS8 (Screenshoot nga LS8)

AK ne vendimin e vet konstaton, qe LandStar 8, nuk ofron mundesi te importimit/eksportimit te të dhenave në formatet Shapefile

Pyetje per OSHP: Ky fakt ku te con ne pohimin apo mohimin e formatit Shp?

FAKTI 7: Format DWG dhe Formati Shp (pa koment)

LandStar 8 is built around easy-to-use workflow management and an intuitive graphical interface designed to help efficiently complete high-precision surveying and mapping projects. **Landstar 8** versatile and integrates all surveying features for different applications, including **construction surveying**, control point measurement, native **CAD** project support, fast and accurate points, line and surfaces stakeouts, road construction, **GIS** data acquisition, and more. Its comprehensive industry-standard data **import and export formats** allow LandStar 8 to be seamlessly integrated existing software environments and ensure instant productivity.

Burimi: D3_Datsheet LS8, faqe 2, paragraf 2 (Screenshoot nga LS8)

Kujdes: A eshte CAD DWG dhe me shume se DWG?

Kujdes: A eshte GIS Shp dhe me shume se Shp?

KUJDES: Me kete deshmi, si eshte e mundur qe AK te pretendoje te kunderten?

AK ne vendimin e vet konstaton, qe LandStar 8, nuk ofron mundesi te importimit/eksportimit te të dhenave në formatet DWG

AK ne vendimin e vet konstaton, qe LandStar 8, nuk ofron mundesi te importimit/eksportimit te të dhenave në formatet DWG dhe Shapefile

Pyetje per OSHP: Ky fakt ku te con ne pohimin apo mohimin e formatit DWG dhe Shp?

FAKTI 8: Formati DWG (pa koment)

ADVANCED DISPLAY OF BASE MAPS

CAD base map rendering in seconds

LandStar 8's proprietary **MetaCAD** graphics engine opens **DWG** and **DXF** base maps faster, with smoother rendering and an improved user experience. **DXF** files up to 200 MB can be opened on CHCNAV handheld controllers in less than 10 seconds. Smart base map functions include "Quick Code" for one-click feature coding to automatically create line features to increase project productivit LandStar 8 supports the opening of external reference files, automatically recognizes **CAD** length units, and allows editing of **CAD** base maps directly in the field

Burimi: D3_Datsheet LS8, faqe 2, paragraf 4 (Screenshoot nga LS8)

Kujdes: Sa here duhet te permbahet nocioni DWG, CAD, DXF, MegaCAD qe dikush

te kuptoje qe formati DWG supportohet?

AK ne vendimin e vet konstaton, qe LandStar 8, nuk ofron mundesi te importimit/eksportimit te të dhenave në formatet DWG

AK ne vendimin e vet konstaton, qe LandStar 8, nuk ofron mundesi te importimit/eksportimit te të dhenave në formatet DWG dhe Shapefile

Pyetje per OSHP: Ky fakt ku te con ne pohimin apo mohimin e formatit DWG?

FAKTI 9: Formati DWG (pa koment)

Sharp and smooth DWG/DXF

Burimi: D3_Datsheet LS8, faqe 3, kapitulli Features, Rreshti 17 (Screenshoot nga LS8)

FAKTI 10: Formati DWG (pa koment)

Support automatic rotation of CAD base map

Burimi: D3_Datsheet LS8, faqe 3, kapitulli Features, Rreshti 18 (Screenshoot nga LS8)

FAKTI 11: Formati DWG (pa koment)

Support opening CAD external references

Burimi: D3_Datsheet LS8, faqe 3, kapitulli Features, Rreshti 19 (Screenshoot nga LS8)

AK ne vendimin e vet konstaton, qe LandStar 8, nuk ofron mundesi te importimit/eksportimit te të dhenave në formatet DWG AK ne vendimin e vet konstaton, qe LandStar 8, nuk ofron mundesi te importimit/eksportimit te të dhenave në formatet DWG dhe Shapefile

Pyetje per OSHP: Ky fakt ku te con ne pohimin apo mohimin e formatit DWG?

Konkluzioni i fakteve pa koment

Ne kemi paraqitur 11 fakte pa koment, te cilat vertetojne qe vendimi i AK eshte ne kundershtim me faktet dhe realitetin.

Ne kemi hasur shpesh AK me qendrime kontradiktore, te gabuara dhe ne kundravajtje ligjore, por rasti aktual eshte padyshim rast me i vecante, qe paraqitet ne OSHP, nga krijimi i OSHP dhe me siguri nuk do arrihet nga askush edhe ne te ardhmen.

Nuk mund te gjendet sot asnje iPhone apo iPad, pamvaresiht, nga cili prodhues dhe software (windows, andoid apo iOS), qe nuk permban Google Map apo nje skice 2D dhe 3D Por Google Map dhe/ose cdo harte ose skice eshte Shapfile.

Cdo Skice 2D ose 3D eshte Format CAD

CAD eshte Nocioni Ombrelle i DWG, DXF, MegaCad, AutoCad, 3D Civil dhe cdo progarmi te ngjashem te prodhuesve te ndryshem.

Fakte dhe Detaje me Koment

Fakti 12: Komsioni Vleresues ne kundeshtim me LPP

Komisioni i Vleresimit Teknik eshte formuar ne shkelje te LPP.

RrPP 001/2022, Neni 39.5 obligon AK, qe anetaret e Komisinit Vleresues „*....te perbehen nga anetare me aftësi te duhura dhe njohuri relevante te fushes…*"

Neni 39.9 eshte me shtrengues dhe konkret dhe kerkon qe „*AK duhet te angazhoje eksperte te jashtem…..nese eksperte te tille nuk ka brenda AK….*"

AK, edhe pse disponon nje Departament Gjeodezie, angazhon persona jashte fushes se gjeodezise dhe kete e ben ne menyre te perseritur dhe inatcore edhe pse ky fakt eshte reklamuar nga te gjithe OE pjesemarres ne tender!!!

AK, si ent publik, nuk ka vetem detyrimin te jete e drejte dhe me integritet, por nuk duhet as te lejoje qe te lind optika, qe eshte e padrejte dhe pa integritet.

Fakti 13: Shkelja e Kodit Civil dhe Kodit te Punes te RK

Kodi i Punes, i bazuar ne Kodin Civil te RK, a ndalon punedhenesin, edhe ate privat, por sidomos punedhenesin publik, qe te angazhoje punemarresin ne detyra qe nuk përfshihen ne kontraten e punes (Job-Description).

Ligjberesi nuk e ka vendosur me kot kete ndalese ligjore, por sepse kjo i hap rrugën abuzimit me punemarresin dhe keqperdorimin e tij per qellime te caktuara. Punemarresi duke u angazhuar dhe marre vendime ne fusha te panjohura per te, probabiliteti per te gabuar edhe pa dashje, apo per tu manipuluar nga te trete, eshte shume i madh.

Ligji as nuk e zhvesh, as nuk e amniston punedhenesin nga pergjegjesia kur ai abuzon me punemarresin, duke e vendosur ne detyra, qe ai (punemarresi) nuk eshte ne gjendje te verifikoje ligjshmerine teknike, jurdike dhe pasojat e vendimeve te tij.

Kembengulja e AK, edhe pas reklamimit te OE, per te angazhuar te njejtit persona, te huaj per fushen, apo orthodoksia e AK per te penguar perfshirjen e specialisteve te fushës (gjeodetet) ngre dyshime te renda per integritetin e punonjesve civil pergjegjes per kete tender.

Fakti 14: Refuzimi me vullnet te plote i transparences se tenderit

Bazuar ne RRPP 001/2022, Neni 38, si dhe neni 40.8 i mundesojne si AK edhe tenderuesit, qe te sqaroje tenderin e vet. Bazuar ne keteo Nene ne i kemi propozuar AK dy mundesi:

1. te demostrojme produktin ne ambjentet e AK, ne cdo kohe qe ajo do te desheronte, dhe/ose

2. Te presantojme produktin online ne cdo kohe qe do percaktohej nga AK.

Por AK ne vend qe te pranonte nje nga keto mundesi, I refuzoi te dyja!

Fakti 15: Refuzm i Detyrimeve Ligjore nga AK

Date 29.11.2023, OE DWH-ALBANIA shpk i kerkon me shkrim AK te njihet me dokumentat e tenderit, qe prodhon AK pas dorezimit te Kerkeses Per Rishikim (pas date 24.11.2023).

Afati i dorezimit te informacionit ka perfunduar me date 4.12.2023. AK deri me date 5.12.2023 kur eshte pregatitur Kerkesa per rishikim ne OSHP nuk ka dhene asnjë informacion dhe pergjigje.

Refuzimi i dokumentave te dosjes eshte shkelje e rralle, sepse edhe penaliteti per nje shkelje te tille nga ligja eshte taksativ „heqje e licences se prokurimit", sidomos kur je perserites, si edhe eshte punonjesi civil i prokurimit te AK.

Ketu lind pyetje: Cfare e detyron AK te refuzoje transparencen ne menyre te përsëritur refuzim te presantimit te produktit, si dhe refuzimin e dorezimit te dokumentave te rivleresimit te kerkeses per rishikim.

Kerkesa per OSHP:

Ne i kerkojme OSHP, rrezimin e vendimit te padrejte, arbitrar dhe abuziv te AK dhe te kaloje lenden ne rivleresim.

KRITERET PËR VLERËSIM

Aneksi 1-Specifikimet teknike të detyrueshme

Kontrolleri i GNSS: 6. Të jetë e paisur me programin për mbledhjen e të dhënave në terren me licence që importon/eksporton këto formate të dhënash: DWG, CSV, txt, Shapefile.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komisioni i vleresimit konstaton se asnjeri nga ofertuesit nuk i ploteson kriteret e kerkuara sipas Aneksi1-Specifikimet Teknike te Detyrueshme, prandaj propozon qe ky aktivitet te ANULOHET.

DWH - ALBANIA SHPK

Kontrolleri i GNSS: Eshte kerkuar: 6. Te jete e pajisur me programin per mbledhjen e te dhenave ne terren me licence qe importon/eksporton keto formate te dhenash: DWG, CSV, txt, Shapefile

Progami i ofruar ne dosje te tenderit Landstar 8, nuk ofron mundesi te importimit/eksportimit te te dhenave ne formatet DWG dhe Shapefile sic jane kerkuar ne Aneksin 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Eksperti me datë 19.12.2023 përmes emailit ka kërkuar nga OE ankues që të mundësojë demonstrimin online të funksioneve të aplikacionit Landstar 8.

Me datë 20.12.2023 OE ankues ka dorëzuar video regjistrimin e demonstrimit të funksioneve të aplikacionit.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Lidhur me këtë lëndë janë nxjerr vendime të mëparshëm të OSHP - së, më numër: 2023/0362 i datës: 16.08.2023 dhe 2023/0638 i datës 18.10.2023.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **DWH - ALBANIA SHPK**

Sqarim hyrës

Parashtruesi i ankesës ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 24.11.2023, për të cilën AK me datë 30.11.2023 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Pretendimi ankimor

Parashtruesi i ankesës – OE "DWH Albania" (më tej OE ankues) pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe RrPP kur ka vendosur që OE ankues nuk plotëson specifikimet teknike të detyrueshme.

Rrethanat e çështjes

AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 23.11.2023 ka paraqitur arsyetimin e eliminimit si vijon: "*Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave te dhëna ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak te arsyjeve ne vijim: Kontrolleri i GNSS: Eshte kerkuar: 6.Te jete e pajisur me programin për mbledhjen e te dhenave ne terren me licence qe importon/eksporton keto formate te dhenash :DWG, CSV, txt, Shapefile. Programi i ofruar ne dosje te tenderit Landstar 8, nuk ofron mundësitë importimit/eksport imit te te dhenave ne formatet DWG dhe Shapefile sic jane kerkuar ne Aneksi n 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESH ME*"

AK në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1-Specifikimet teknike të detyrueshme, tek specifikimet për Kontrollerin ndër të tjera ka specifikuar kërkesën: "6.Të jetë e pajisur me programin për mbledhjen e të dhënave në terren me licence që importon/eksporton

këto formate të dhënash: DWG, CSV, txt, Shapefile,"

OE ankues në tenderin e tij ka dorëzua edhe dokumentin me emërtimin "LS8_DS_EN (2)" i cili është broshura e aplikacionit LandStar 8 - aplikacioni për grumbullimin e dhënave në terren të prodhuesit CHCNAV.

OE ankues me datë 24.11.2023 si palë e pakënaqur me vendimin e AK-së, ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim në AK.

Së bashku me kërkesën për rishqyrtim ka dorëzuar edhe dokumentin me të dhënat e personit z.Daniel Zavorszky, Inxhinier i mbështetjes teknike, CHC Navigation Europe kft, Zyra e Budapestit, Hungari, në të cilin shënohet: "*Partneri ynë i biznesit, Ing i diplomuar z.Ilir Alla, Partner Menaxhues i kompanive tona të tregtimit në Austri, Shqipëri dhe Kosovë na informoi se mund të gjeni eksport/import të formateve të mëposhtme txt, csv, shp dxf dwg në LT800, të kërkuara nga ju. Si fillim duhet të them, se këto funksione nuk janë veçori ose funksionet e kontrolluesit, por të softuerit në terren, në rastin tonë, LandStar 8. Tani po vij te pyetja juaj thelbësore: LS8 mbështeti formatet IMPORT: DAT, TXT, CSV, XLSX, XLS, DXF\DWG, SHP, KML\KMZ, TIFF, MBTILES, JPG dhe POLYLINE. LS8 mbështet formatet EXPORT: DAT, TXT, CSV, XLSX, XLS, DXF, SHP, KML, KMZ, HTML dhe data RAW Në fletën e të dhënave nga Landstar 8, faqe 2, §2 i keni të gjitha përgjigjet për kërkesën e mësipërme në një paragraf, ku thuhet se LS8 mbështet ndërtimin, rilevimin .....CAD dhe GIS...., por jo vetëm në § 2, por edhe në pjesën Tech.Spec. GPS mat çdo pikë në tre dimensione x, y, z. Formati i përgjithshëm (termi) për pikat matëse GPS është .txt (shih figurën 1) dhe .csv (shih figurën 2). Nuk ka kontrollues ose softuer GNSS që nuk mund të japë matjet në .txt dhe .csv. CAD është një term ombrellë për dxf, dwg dhe versione të tjera CAD. Në fletën e të dhënave LS8, dwg/dxf dhe CAD përmenden disa herë, por këtë mund ta shihni edhe në foto. 3.1 dhe 3.2 Termi ombrellë GIS qëndron për Harta. Fleta e të dhënave LS8 faqja 1 dhe 3 përmban disa fotografi të hartave. Harta është termi ombrellë për .shp (shih foton 4). Gjithashtu për hartat ne mbështesim zgjidhjet WMS dhe gjithashtu mbështesim disa harta online: Ne kemi disa pajisje në tregun e Shqipërisë dhe Kosovës. Ju mundeni te kontaktoni shitësit tanë për të prezantuar Landstar 7 (LS8 është i ri) drejtpërdrejt. Mund të më kërkoni gjithashtu të bëj një prezantim online. Ju do të jeni në gjendje të shihni që produktet tona kanë të gjitha funksionet që kanë Leica ose Trimble. Shpresoj që kjo të ketë sqaruar çdo pyetje ose dyshim të pabazë që mund të keni.*"

AK, ne vendimin e datës 20.11.2023 për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ka dhënë arsyetimin si vijon: ne Udhëzuesin e prokurimit 001/2023, ne lidhje me mungesën e specifikave teknike, pika 10.1 thotë: Mungon specifikacioni Teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu ("specifikimit teknik" – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç ne raste kur OE nuk mund të dorëzoj specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/ përime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jene ne përputhje, Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

Eksperti me datë 19.12.2023 përmes emailit ka kërkuar nga OE ankues që të mundësojë demonstrimin online të funksioneve të aplikacionit Landstar 8. Me datë 22.12.2023 OE ankues ka dorëzuar video regjistrimin e demonstrimit për të cilin eksperti sqaron si vijon: në demonstrim shihet se aplikacioni është Landastar, më tej në funksionin import, tek seksioni text file paraqitet opsioni i importimit në formatin.txt, më tej në seksionin other formats

paraqiten në listë të renditur formatet ku janë edhe formatatet .DWG file dhe .SHP file. Poashtu tek funksioni export, në seksionin text file paraqitet opsioni i eksportimit në formatin.txt, poashtu në seksionin other formats listohen formatet .DWG dhe .SHP. Imazhi nga demonstrimi i funksionit të eksportimit të të dhënave në formate të ndryshme.



Imazhi nga demonstrimi i hapjes së aplikacionit Landstar.



Imazhi nga demonstrimi i funksionit të importimit të të dhënave në format .txt.



Imazhi nga demonstrimi i funksionit të importimit të të dhënave në formate të ndryshme.



Imazhi nga demonstrimi i funksionit të eksportimit të të dhënave në format .txt.



Imazhi nga demonstrimi i funksionit të eksportimit të të dhënave në formate të ndryshme.

Vlerësimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor

Fillimisht eksperti sqaron se në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit AK tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional nuk ka kërkuar dorëzimin e katalogut (broshurës) si kërkesë përkatsisht dëshmi në lidhje me plotësimin e specifikimeve teknike. Arsyetimi i AK-së në vendmin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, i bazuar në nenin 10.1 të Udhëzuesit për prokurimin publik nuk është i qëndrueshëm. Kjo për faktin se në nenin e sipërpërmendur përshkruhet rrethana kur mungon "specifikimi dhe katalogu" në të njejtën kohë. Në tenderin e dorëzuar nga OE ankues është dorëzuar katalogu me informatat, përkatësisht formatet në

formë të përgjithësuara. Si përfundim, eksperti vlerëson se bazuar në informacionin e prezantuar në katalog, kërkesën për rishqyrtim të datës 24.11.2023 dhe video regjistrimin e demonstrimit të aplikacionit Landstar, të dorëzuar nga OE ankues me datë 20.12.2023, aplikacioni softuerik mundëson importimin dhe eksportimin në formatet DWG, CSV, TXT dhe Shapefile për të cilat AK ka konstatuar se nuk janë ofruar si mundësi nga aplikacioni softuerik i ofertuar nga OE ankues. Andaj pretendimi ankimor është i bazuar.

Në lidhje me shënimet shtesë të cilat AK i ka dhënë në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 23.12.2023, eksperti sqaron se AK i ka ngritur vetëm si dyshime dhe nuk ka konstatuar rënien ndesh me dispozitë të caktuar të LPP-së apo kërkesave/kritereve të dosjes së tenderit.

Më tej në lidhje me komunikimet e paautorizuara dhe ndarjen e detyrave brenda AK-së, eksperti sqaron se është përgjegjësi e AK-së që të ndërrmarr veprime konfrom LPP-së, Rregullorës për Prokurim Publik dhe Kodit Etik të Prokurimit të aprovuar nga KRPP-ja, në rastet kur veprimet e një zyrtari bien ndesh me dispozitat e akteve përkatëse.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL PRISHTINA SH.A.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **DWH - ALBANIA SHPK**

Kreshnik Spahiu